



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo/Ministry of Innovation and Entrepreneurship
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalni Sekretara - Office of General Secretary

Numër: 170/2019

Datë: 12/03/2019

**FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË START-UP, NË PROMOVIMIN
DHE MBËSHTETJEN E INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË**

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MIN) Nr.01/2018 për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve të plotësuar-ndyshuar me Udhëzimin Administrativ (MIN) Nr.02/2018, MIN fton organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë të aplikojnë për përfaqësues në komisionin për vlerësimin e aplikacioneve sipas Thirrjes Publike të MIN për Financimin e START-UP.

-Përfaqësues nga OJQ-të (Një anëtar)

Anëtari përfaqësues i OJQ-së, i cili do të përzgjedhet për të qenë anëtar në komisionin për vlerësimin e aplikacioneve për Start-Up, me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit, nuk duhet të aplikoj ose të jetë pjesë e stafit të ndonjë nga Start-Up që aplikojnë për financim sipas Thirrjes së datës 04.03.2019 të shpallur nga MIN.

Kualifikimi dhe përvoja e përfaqësuesit të OJQ-së

- Diplomë Universitare;
- Përvojë në përgaditjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike;
- Përvojë në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjen për mbështetjen financiare nga burimet publike;
- Njohje e dokumenteve strategjike dhe politikave prioritare në fushën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë;
- Njohje e Metodologjive ekzistuese sektoriale në fushën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

CV-të dërgohen në e-mail adresën si në vijim: info.min@rks-gov.net

Afati i fundit për aplikim është 18.03.2019 në ora 16:00. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, drejtohuni në info.min@rks-gov.net, si dhe në numrin: 00381 38 200 69 519.